



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

Data 29.07.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“BLERJE SUVENIRE”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **44423000-1**

VLERA E FONDIT LIMIT: **3,185,000 (tre million e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë pa Tvsh;**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranëka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2022, 2023**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës;

Argumentimi:*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2. Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (**2022, 2023**) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit

Argumentimi:*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Shënim: *** Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari

dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.*

a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontrata të shoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

Ose

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e

ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryej shërbimin e transportit dhe dorëzimin e mallrave/ artikujve objekt prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor.

Argumenti: *Ky shërbim do të ofrohet gjatë gjithë vitit kalendarik 2024 sa here që AK do të ketë nevojë. Per këtë arsye është i nevojshëm suporti për kryerjen e këtij shërbimi prane ambjenteve të Bashkisë Tiranë sipas kërkesave të këtij autoriteti në mënyrë që edhe kontrata të realizohet me sukses dhe të mos hasen pengesa apo vonesa në realizimin dhe lëvrimin në kohë të mallit.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën dhe oren e hapjes së ofertave nga një mostër në ambjentet e AK (Drejtoria e prokurimeve), 1(një) copë për artikujt/mallrat objekt prokurimi. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST, si më poshtë:

- Kulla sahati të Tiranës (suvenir) me dimension të vogël duhet të jete e argjenduar; me ketëdimensione: Lartësi 22 cm x 3.5 gjerësi, me peshe: 325 gr rezinë dhe 25 gr argjend, me orë funksionale. Duhet të jetë e paketuar në kuti druri ose kadife të personalizuar ose me dedikim.
- Medalione mirënjohje, falenderimi, Nënë Terezë. Medalionet duhet të jenë me logon e Bashkisë Tiranë dhe duhet të jenë me material bakër; me diametër ø 56 mm, pesha e medalionit: 95 gr. Duhet të jetë e paketuar në kuti druri ose të veshur me kadife të kuqe dhe shirit kuq e zi, të personalizuar. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) për tu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnje e errët, kadife.
- Çelësi i Qytetit të Tiranës duhet të jetë me dimensione 15 cm x 3.6 cm; përbërja e tij: argjend 73 gr. Çelësi duhet të jetë i vendosur në kuti druri ngjyrë kafe. Kutia ku do të vendoset çelësi duhet të ketë këto dimensione: 21.5 cm x 21.5 cm. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) për tu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnje e errët, kadife. Çelësi duhet të jetë i vendosur në qendër të kutisë. Çelësi duhet të ketë logon e Bashkisë Tiranë.

Argumentimi: *Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se:*

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

1. Kulla sahati të Tiranës (suvenir) me dimension të vogël duhet të jete e argjenduar; me keto dimensione: Lartësi 22 cm x 3.5 gjerësi, me peshe: 325 gr rezinë dhe 25 gr argjend, me orë funksionale. Duhet të jetë e paketuar në kuti druri ose kadife të personalizuar ose me dedikim.
2. Medalione mirënjohje, falenderimi, Nënë Terezë. Medalionet duhet të jenë me logon e Bashkisë Tiranë dhe duhet të jenë me material bakër; me diametër ø 56 mm, pesha e medalionit: 95 gr. Duhet të jetë e paketuar ne kuti druri ose të veshur me kadife të kuqe dhe shirit kuq e zi, të personalizuar. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) për tu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnje e errët, kadife.
3. Çelësi i Qytetit të Tiranës duhet të jetë me dimensione 15 cm x 3.6 cm; përbërja e tij: argjend 73 gr. Çelësi duhet të jetë i vendosur në kuti druri ngjyrë kafe. Kutia ku do të vendoset çelësi duhet të ketë këto dimensione: 21.5 cm x 21.5 cm. Kutia duhet të ketë mekanizëm lëvizës (mentesha) për tu hapur. Bazamenti i kutisë të jetë ngjyrë vishnje e errët, kadife. Çelësi duhet të jetë i vendosur në qendër të kutisë. Çelësi duhet të ketë logon e Bashkisë Tiranë.

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- *Përsa i përket artikullit **Kulla sahati të Tiranës (suvenir) me dimension të vogël**: Sasia: 130 copë, me dimensione Lartësi 22 cm x 3.5 gjerësi, me peshe: 325 gr rezinë dhe 25 gr argjend, me orë funksionale. Duhet të jetë e paketuar në kuti druri ose kadife të personalizuar ose me dedikim, sqarojmë se specifikimet e kërkuara janë të domosdoshme pasi kjo kullë sahati karakterizon kulturën dhe historinë e qytetit të Tiranës dhe jep imazh shumë të qartë të kullës së sahatit të Tiranës. Është një dhuratë e cila u jepet qytetarëve shqiptar ose të huaj, në rast festash zyrtare dhe ngjarësh historike. Kutia duhet të jetë sipas këtyre specifikimeve sepse krijon mundësinë e ruajtjes sa më*

mirë të dhuratës. Kërkesa është në përputhje me nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”

- *Përsa i përket artikullit **Medalione mirënjohje, falenderimi, Nënë Terezë**: Sasia 17 copë, Medalionet duhet të jenë me logon e Bashkisë Tiranë dhe duhet të jenë me material bakër; me diametër ø 56 mm, pesha e medalionit: 95 gr. Ky medallion të jetë patjetër me këto specifikime sepse jepet si dhuratë nga kryetari I Bashkisë në shenjë falenderimi për personalitete të njohura të artit dhe kulturës dhe për shërbime të shquara të kryera për qytetin e Tiranës, për qytetar të vendit tonë dhe të huaj që kanë dhënë kontribut në fusha të ndryshme. Janë të personalizuar dhe AK I kërkon rast pas rasti. Mbrapa medalionit operatori fitues merr përsipër shkrimin sipas kërkesave të AK. Kutia duhet të jetë sipas këtyre specifikimeve sepse krijon mundësië e ruajtjes sa më mirë të dhuratës. Kërkesa është në përputhje me nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”*
- *Përsa i përket artikullit Çelësi i Qytetit të Tiranës, sasia 35 copë duhet të jetë me dimensione 15 cm x 3.6 cm; përbërja e tij: argjend 73 gr. Çelësi i Qytetit të Tiranës është specifik dhe simbolik si shenjë mikpritjeje për mysafirët e qytetit. Kutia duhet të jetë sipas këtyre specifikimeve sepse krijon mundësië e ruajtjes sa më mirë të dhuratës. Kërkesa është në përputhje me nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje Suvenire”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit